



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE

VENDIM

Nr. 8 , Dt. 20.01.2009

Per miratim ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimeve te Gjezhdanices dhe Perroi Fterre, per prodhim te energjise elektrike, subjektit "Hydro Valbona" sh.p.k. Tirane.

Ne zbatim te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet", kreu IV, te Vendimit te K.M-ve nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreu II, te vendimit te K.K.U-it, nr.3, dt. 19.07.2002 "Per miratimin e rregullores te Sekretariatit Teknik, te K.K.U-it, te K.B.U-es dhe A.U. -it", si dhe udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, K.B.U "Vjose":

VENDOSI:

1. Miratimin ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimeve te Gjezhdanices dhe Perroi Fterre, fshati Fterre, komuna Lukove, qarku Vlore, per prodhim te energjise elektrike, subjektit "Hydro Valbona" sh.p.k. Tirane.
2. Sasia e ujit qe jepet ne perdorim, per prodhim te energjise elektrike, do te jete: Per HEC-in Nr.1 $Q_{mes(1)} = 0.5 \text{ m}^3/\text{sek}$ dhe per HEC-in Nr.2 $Q_{mes(2)} = 2 \text{ m}^3/\text{sek}$.
3. Veprat e marrjes te ujit, do te jene perkatesisht ne vendet me koordinata:
Per HEC-in Nr.1: $X1 = 44 \ 43 \ 506$ $Y1 = 44 \ 05 \ 512$ $Z1 = 330 \text{ m}$
Per HEC-in Nr.2: $X2 = 44 \ 42 \ 583$ $Y2 = 44 \ 04 \ 447$ $Z2 = 174 \text{ m}$
4. Periudha e shfrytezimit te ujit, gjate gjithë vitit, (nga 1 qershor deri me 30 shtator, sasise te mesiperme, do ti zbriten 100 l/sek , qe do te perdoret per konsum te popullates, pirje dhe ujitje).
5. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.
6. Ky vendim hyne ne fuqi pas procedurave te konkurimit dhe miratimit te kontrates te koncesionit nga Keshilli i Ministrave dhe lejes te ujit nga K.B.U "Vjose".

PERGJEGJESIA A.U.B "VJOSE"

Vezir METAJ



KRYETARI I K.B.U "VJOSE"

Hasan HALILI

